# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-444496**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | U plagos me drapër nga daja i Zegjine Çaushit, flet 67-vjeçari: Mbrëmë Bledari erdhi të më merrte vajzën! E ka rrëmbyer edhe më parë dhe e ka përdhunuar për 45 ditë me radhë! - Shqiptarja.com |
| ADRESA | `https://shqiptarja.com/lajm/u-plagos-me-draper-nga-daja-i-zegjine-caushit-flet-67vjecari-mbreme-bledari-erdhi-te-me-merrte-vajzen-e-ka-rrembyer-edhe-me-pare-dhe-e-ka-perdhunuar-per-45-dite-me-radhe` |
| BURIMI | shqiptarja.com |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 20:20:21 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 20:18:30 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `8378f7c7d3ad35156c012de0f7b7cae93430419ab9a6f71c9dce51446428f77e` |
| TEKSTI | `49dfdb47e70ec3453673bded4414fa0fa09bda8b32e5e8c0348dcd9fcbd978c8` |
| PAMJA | `46ff61aa354e7367ae18d111ebf7d98c511966b42e6b5adfbf9a639eaf067a63` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `7d3fc09db291c298a20858c92f50550cb3c4c8f8bbffb4b8652d28e64c72e3d6` |
| E MËPARSHMJA | `93c64347e276f64762c03f4a46d136eac5942084ebaf84cce538a4d7c041e8f2` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/7d3fc09db291c298a20858c92f50550cb3c4c8f8bbffb4b8652d28e64c72e3d6`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kronikë

# U plagos me drapër nga daja i Zegjine Çaushit, flet 67-vjeçari: Mbrëmë Bledari erdhi të më merrte vajzën! E ka rrëmbyer edhe më parë dhe e ka përdhunuar për 45 ditë me radhë!

*Enver Grëmaj ka tronditur me dëshminë e tij, teksa ka treguar se e kishte njohur Bledar Bakajn përmes motrës së tij, e cila banon në të njëjtin fshat, dhe i kishte premtuar se do ta ndihmonte për një vend pune, duke qenë se është dhe daja i deputetes Zegjine Caushi.*

■ Roskovec/ Plagosi me drapër ish-vjehrrin, arrestohet daja i deputetes Zegjine Çaushi (EMRAT)







*Foto ilustruese*

Redaksia
14 Shtator, 22:15 | **Përditesimi: 14 Shtator, 22:19**

Share Tweet

"Kam përjetuar gjëra të tmerrshme. Kam nevojë për psikolog". Kjo ka qenë thirrja e dëshpëruar e 34-vjeçares Merita Grëmaj nga fshati Suk i Roskovecit. Dhuna sistematike e 52-vjeçarit Bledar Bakaj, daja i deputetes socialiste Zegjine Caushi, është kthyer në makthin më të madh për të renë fatkeqe.

Nga spitali i Fierit, babai i saj, 67-vjeçari Enver Grëmaj, rrëfen ngjarjen e rëndë të ndodhur një natë më parë në banesën e tij, teksa 52-vjeçari është hedhur nga porta dhe e ka qëlluar me drapër në këmbë, pasi i moshuari është përpjekur të mbrojë vajzën, që ai tentoi ta rrëmbente.

Enver Grëmaj ka tronditur me dëshminë e tij, teksa ka treguar se e kishte njohur Bledar Bakajn përmes motrës së tij, e cila banon në të njëjtin fshat, dhe i kishte premtuar se do ta ndihmonte për një vend pune, duke qenë se është dhe daja i deputetes Zegjine Caushi.



LEXO EDHE:
**'Muzak Fest' rikthen artin në Apoloni! Emra të njohur të skenës shqiptare bashkojnë poezinë, muzikën dhe historinë**

Pas takimit në Roskovec, 52-vjeçari premtoi se do ta ndihmonte jo vetëm për punësimin e vajzës, por dhe në spital, pasi ajo vuan nga anemia dhe alergjia. Në 26 maj, babë e bijë shkuan për vizitë në spitalin e Fierit, por ai, duke dalë nga dera e pasme, e kishte marrë vajzën për në Tiranë, por kishte përfunduar

e përdhunuar gjatë rrugës.

Për 45 ditë, thotë Enveri, vajza është mbajtur me forcë në banesën e 52-vjeçarit, por nuk kontaktoi me të, pasi mund të kishte ikur dhe me dëshirë. Por, kur është kthyer në banesë, u ka treguar prindërve se ishte përdhunuar dhe mbajtur me forcë nga 52-vjeçari. *"Kërkuam urdhër mbrojtjeje, por kërcënimet kanë qenë të vazhdueshme"*, thotë babai i vajzës.

Policia e Fierit, ndërkohë, e ka arrestuar 52-vjeçarin menjëherë pas ngjarjes së mbrëmshme, afër banesës së tij në fshatin Mbërs. Ndërsa tre familjarët e shokuar vijojnë të ndodhen në spitalin e Fierit, në pritje të drejtësisë.

-------------------------------

**Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë**

R.Xh/Shqiptarja.com

TAG: Roskovec plagosje zegjine caushi Bledar Bakaj Fier

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★ ★ ★ ★ ★ 5.0 / 5 (1 vlerësim)

LAJMET MË TË VLERËSUARA

**Komente**

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH com

**Sondazhi i ditës:** 16 Shtator, 14:18

**Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?**

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

## Lajme të tjera



**Aksident në Fier-Seman, makina del nga rruga dhe përfundon në kanal, plagoset shoferja (EMRI)**

20 Shtator, 12:25




**Tjetërsimi i tokës në Seman, lihen në burg ish-drejtorët e Kadastrës! 'Arrest shtëpie' biznesmenit**

19 Shtator, 17:50



**Kaloi rininë në internim, poeti vlonjat Neki Ngucaj zgjedh bibliotekën e Lushnjës për të promovuar 16 librat e tij**

19 Shtator, 16:26



**Fier/ U dogjën 500 ha ullishte dhe 15 objekte, numri 2 i policisë: Shkak transformatori i OSHEE! 41 të arrestuar për zjarret e qëllimshme, shumica mbi 70-vjeç (VIDEO)**



Marsela Topi

19 Shtator, 15:58



**Mbahet në Toshkëz të Lushnjës, 'Festa e vreshtarisë'! Tradita dhe puna e fermerëve në një panair**



Yrjet Saliasi

19 Shtator, 15:52



**Aksident në aksin Fier–Patos, makina përplaset me motorin e shpërndarësit të picave! Plagoset drejtuesi (VIDEO)**

19 Shtator, 13:45








**Pas Semanit, ish-drejtori i Kadastrës së Fierit dyshohet se tjetërsoi edhe 71.7 hektarë tokë në Levan, i sekuestrohen 716 mijë euro! Gjykata e lë në burg**
19 Shtator, 11:19

**Përfshihet nga flakët Benzi në Fier, tymi mbulon parkimin nëntokësor (VIDEO)**
18 Shtator, 11:37

**Parkimet e gabuara/ Rrugorja e Fierit monitorim me dron për shkelësit e qarkullimit (VIDEO)**
18 Shtator, 11:17




**Kontrolle intensive të policisë rrugore në rrugët e Fierit, 694 gjoba për shpejtësi në një javë! 7 drejtues mjetesh nën hetim, 2 në pranga**
17 Shtator, 16:04



**Plagosi babanë e ish-partneres, Gjykata e Fierit lë në burg dajën e deputetes së PS (VIDEO)**
17 Shtator, 11:18




**Fier, zbulohet skema e tjetërsimit të 1143 hektarë tokë në Seman, në pranga dy ish-drejtorët e Kadastrës dhe 'pronari'! Sekuestrohet toka dhe 150 mijë euro**
Marsela Topi
17 Shtator, 10:15



[Shqiptarja.com]

Kerko

© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.